



Nr.01/2018, datë 21.03.2018

Në bazë të nenit 11 (njëmbëdhjetë) të udhëzimit administrativ të MASHT-it nr.2/2016, Drejtoria e shkollës bën këtë:

FTESË PËR OFERTË

Pas vendimit të marrë nga këshilli drejtues i shkollës dhe i prindërve ftojmë të gjitha agjensitë turistike të marrin pjesë në ftesë për ofertë të ekskursionit të maturantëve të SHMT „Skender Luarasi” në Suharekë.

Ekskursioni do të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë nga data 16 prill 2018.

Kohëzgjatja e ekskursionit është 5 (pesë) netë (pansione të plota).

Në ekskursion do të marrin pjesë rreth 300 nxënës.

Në ofertë të parashihet çmimi i akomodimit, ushqimit (mëngjesi + dreka + darka), transportit dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave në muze dhe kala që parashihen në rrugëtimin e përcaktuar nga Këshilli i shkollës.

Agjencionet turistike që konkurrojnë duhet t'i plotësojnë këto parakushte:

1. Agjencioni duhet të ketë licencën “D” nga Ministria. Ofertës t'i bashkëngjiten fotokopjet e këtyre dokumenteve.
2. Të ketë bërë kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore-Ofertës t'i bashkëngjiten dëshmitë për këtë për të gjithë autobusët që do të përdorën në ekskursion.
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e ekskursionit
4. Duhet të ofroj dëshmi për akomodimin në Hotel në të cilin plotësohen kërkesat të këshillit Drejtues të Shkollës dhe Prindërve (Siguria, Rrethojat, Ushqimi, Ballo për aktivitete të lira, projektor, hapsier e dedikuar e promovimit të projekteve të nxënësve).
5. Për shoferet angazhuar në ekskursion nga agjencioni duhet të kenë certifikatën e mjekut, CPC-në dhe kopjet e patentshoferit.
6. Agjencioni duhet të siguron përkujdesje mjekësore për pjesëmarrësit e ekskursionit gjatë tërë kohëzgjatjes së tij. Ofertës t'i bashkëngjiten leja e punës e mjekut dhe fotokopja e kontratës me të, për përkujdesje gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit.
7. Afati i konkurrit 7 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit, ofertat dorëzohen në DKA në emër të shkollës.
8. OE i kërkohet të bëjë një konfirmim me shkrim që do të jetë në gjendje të mënjanon shpejtë prishjet eventuale të ndonjë autobusi ose nëse është e nevojshme pa vonesë ta zëvendëson atë.
9. Dokumentet jashtë afatit të paraparë nuk pranohen.
10. Dokumentet jo komplete nuk shqyrtohen.

Fituesi i ofertës do të zgjidhet operatori ekonomik, i cili plotëson të gjitha kriteret e mësipërme dhe ka ofertën më të mirë, vlerësuar nga Komisioni, përbërja e të cilit është përcaktuar me UA 2/2016.

-Formulari i paraqitjes së ofertës dhe rrugëtimi i ekskursionit i hartuar nga Këshilli drejtues i shkollës merren në SHMT „Skender Luarasi” nga data 21.03.2018 në ora 08.00-15.00.

Pranimi i ofertave bëhet deri më: 29.03.2018 deri në ora 13:00. Hapja e ofertës bëhet në SHMT „Skender Luarasi” me datë: 29.03.2018 në ora 13:30.

Suharekë, 21.03.2018

Drejtori
U.D Teuta Berisha

